Njoftim për përqendrim me të cilin EAST BOX SHPK Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojë kontrollin mbi TERRA CASUS d.o.o., Republika e Kroacisë

(lënda nr. 08-157/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 11.11.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim, me të cilin EAST BOX SHPK BEOGRAD-NOVI BEOGRAD (EAST BOX DOO BEOGRAD-NOVI BEOGRAD), me seli në Bulevardin Mihajlo Pupina nr. 115b, 11000 Beograd, Republika e Serbisë, synon të fitojë kontroll të vetëm të drejtpërdrejtë mbi TERRA CASUS d.o.o. (TERRA CASUS d.o.o.), shoqëri e organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kroacisë, me seli në Svaçiqeva nr. 7, 21000 Split, Republika e Kroacisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Në Republikën e Serbisë, EAST BOX SHPK BEOGRAD-NOVI BEOGRAD kryesisht ushtron veprimtari të shitjes me pakicë të veshjeve, këpucëve dhe produkteve të ngjashme të modës të brendit „Replay“, në dyqane të specializuara, si dhe nëpërmjet porosive postare dhe internetit.

Tregtia me shumicë e veshjeve, këpucëve dhe produkteve të ngjashme të modës përbën një pjesë të vogël të veprimtarisë afariste të shoqërisë.

EAST BOX SHPK BEOGRAD-NOVI BEOGRAD është në pronësi të shoqërisë FASHION BOX B.V., me seli të regjistruar në Rokin nr. 92, Amsterdam, Holandë, e cila zotëron 51% të pjesëve, dhe të personit fizik z. Milija Baboviq, i cili zotëron 49% të pjesëve.

FASHION BOX B.V. dhe z. Milija Baboviq ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi EAST BOX SHPK BEOGRAD-NOVI BEOGRAD.

Z. Milija Baboviq zotëron 100% të pronësisë në SHOQËRINË PËR EKSPORT-IMPORT, TREGTI ME SHUMICË DHE PAKICË TË TEKSTILIT DHE KONFEKSIONIT FASHION COMPANY SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR, BEOGRAD (NOVI BEOGRAD).

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, z. Milija Baboviq, në mënyrë të tërthortë nëpërmjet Fashion Company, ka një shoqëri të varur të regjistruar – Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe produkteve tekstile EUROFASHION TRADE SHPK import-eksport Shkup, me seli të regjistruar në rr. Nikolla Klusev nr. 6, kati 7, Shkup – Qendër, Shkup. Veprimtaria e regjistruar e EUROFASHION TRADE SHPK është 47.710 – Tregtia me pakicë e veshjeve.

Veprimtaria e regjistruar e **TERRA CASUS** është 68.20 – Dhënia me qira dhe menaxhimi i pasurive të paluajtshme në pronësi ose të marra me qira (lizing).

TERRA CASUS nuk ka shoqëri të lidhura ose degë të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit në fjalë, tregu përkatës mund të përkufizohet si tregu i tregtisë me pakicë të veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve të modës në dyqane të specializuara, si dhe tregu i tregtisë me pakicë të veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve të modës nëpërmjet porosive postare dhe internetit.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

13.11.2026

Shkup